

VENDIM
Nr.654, datë 25.9.2003

**PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KURRIKULAVE DHE TË STANDARDEVE (IKS) DHE
PËR SHKRIRJEN E INSTITUTIT TË STUDIMEVE PEDAGOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për arsimin parauniversitar" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Institutit të Kurrikulave dhe të Standardeve (IKS), si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, me objekt kryesor hartimin e zhvillimin e kurrikulave dhe të standardeve dhe realizimin e studimeve psiko-pedagogjike për arsimin parauniversitar.
 2. Shkrirjen e Institutit të Studimeve Pedagogjike.
 3. Struktura dhe organika e IKS-së miratohen nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.
 4. Ministri i Arsimit dhe i Shkencës miraton rregulloren e funksionimit të IKS-së.
 5. Drejtuesit e IKS-së (drejtori dhe kancelari) emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".
 6. Nëpunësit e IKS-së (përgjegjës sektori, specialistë) emërohen pas një procesi konkurrues, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
 7. Pagat e drejtuesve dhe të nëpunësve të IKS-së caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
 8. Numri i punonjësve të IKS-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.
 9. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, rezultojnë pa vende pune, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
 10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano